

PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN

“Impiant franksionimi i inerteve lumore”

Rishikim i kushteve të lejes III.1.B.
nr. PN-6171-09-2013 / date 11.09.2013

Vendndodhja: Fshati Shënkoll, 1 km larg qendrës së Fshatit Shënkoll, Njësia Administrative Shënkoll, Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë.

Kërkues: Subjekti juridik “Rafaelo 2002” sh.p.k. / NIPT K22113003Q

Administratori: z. Eduart Gjinaj



Janar, 2022

TABELA PËRMBLEDHËSE

1.TË PËRGJITHSHME	3
2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT	5
2.1. Qëllimi i projektit	
2.2. Vendndodhja e aktivitetit	
2.3 Procesi teknologjik dhe karakteristikat e tij	
3. INFORMACION PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS	12
3.1. Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis	
3.2. Masat e nevojshme për zbutjen e ndikimeve	
4.PROGRAMI I MONITORIMIT	14
4.1.Qëllimet e monitorimit mjedisor	
4.2. Objektivat e Monitorimit	
5. PËRPARESITË E PROJEKTIT/PËRFUNDIME	15



1. TË PËRGJITHSHME

Shoqëria "RAFAELO 2002" me administrator z.Eduart Gjinaj, është një subjekt juridik i regjistruar në QKB me NUIS **K22113003Q**. Sipas ekstraktit të QKB-së, subjekti "RAFAELO 2002" është shoqëri aksionare, themeluar me 13.09.2002.

Zyra qendrore/zyra e përfaqësimit në Shqipëri është në adresën: Rruga "29 Nentori", Kthesa e Kamzës, zona kadastrale Nr.8310, nr.pasurie 12/104, Njësia Bashkiake Nr.11, Tiranë.

Subjekti "RAFAELO 2002", si objekt të veprimtarisë së tij ka:

Import-Eksport te mallrave industriale, ushqimore, materiale ndertimi (nga te gjitha llojet). Makineri dhe pjese nderrimi, mallra elektrike, hidraulike dhe hidrosanitare, lende drusore, te perpunuara dhe te paperpunuara, etj. Ndertime te ndryshme civile dhe industrial, sherbime te ndryshme ne ndertim nga te gjitha llojet. Linje prodhimi me materiale inerte si: prodhim inertesh nga te gjitha llojet, prodhim tulle, tjegull, pllaka, tubacione, shtylla

elektrike si dhe cdo lloj tjeter prodhim betoni, servise te ndryshme, lavazhe, etj. Transporte me makineri te ndryshme, kombetare dhe nderkombetare. Tregeti, importe dhe eksporte te karburanteve dhe nenprodukteve te tyre. Tregeti ne fushen e ushqimit social si: Bare, restorante, ho tele. Importe-eksporte dhe tregeti te mjeteve

motorike (te gjitha llojeve). Tregeti, perpunim dhe eksport mbeturinash hekuri (skrap) te te gjitha llojeve. Agjensi detare dhe spedicionere. Peshkim me vendndodhje ne portin Durres dhe Shengjin Lezhe. Sherbime ruajtje (roje private) dhe sigurie fizike. Montim katalizatoresh per automjete te ndryshme. Shërbime avokatie. Kembim valutor (Exchange). Ndertim, Operim, Transferim hidrocentrali, prodhim dhe shitje energjie elektrike.

Servis automjetesh: Riparim dhe mirmbajtje te pjeseve mekanike dhe te motorrit, te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove. Riparim dhe mirmbajtje te karrocise, te mjeteve migore me motor dhe rimorkiove. Riparim dhe mirmbajtja e impiantit elektrik, te mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove. Mbledhje depozitim shkaterrim i mjeteve ose pjeseve te tyre te dala jashte perdorimit apo te braktisura. Transport nderkombetar udhetaresh. Transport nderkombetar mallrash per te trete dhe me qera. Transport me mjete jashte norme.

Duke pare të gjithë fushën e veprimtarisë ku operon, subjekti zhvillon aktivitetin "**Impiant frankionimi i inerteve lumore**", me vendndodhje Fshati Shënkoll, 1 km larg qendrës së Fshatit Shënkoll, Njësia Administrative Shënkoll, Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë.

Aktiviteti është në funksion prej vitesh dhe subjekti është i pajisur më parë me Leje Mjedisi të Tipit B me **PN-6171-09-2013 date 11.09.2013**, për aktivitetin përkatës sipas përcaktimeve ligjore të kohës.

Me anë të kësaj përmbledhje jo-teknike dhe njoftimit për informim (formulari 1) kërkohet rishikimi i kushteve të lejes ekzistuese të lejes ekzistuese të mjedisit.

Kapacitetet perpunuese nuk kane pesuar ndryshime prej asaj kohe dhe nuk ka pasur ndryshime domethenese ne impiantin e instaluar nga subjekti.



Subjekti është i pajisur me Vendimin Nr.72 , datë 22.02.2017 për miratimin e “Lejes për Rehabilitimin e Rrjedhës së Ujit në Lumin Mat për Subjektin “Rafaelo 2002” sh.p.k” , të lëshuar nga Këshilli i Basenit Mat. Segmenti që rehabilitohet –Segmenti në fshagtin Shënkoll/ Shënkoll.

Sipërfaqja që rehabilitohet $S = 25'000 \text{ m}^2$.

Subjekti është i pajisur me LEJE PËR REHABILITIM SHTRATI LUMOR Nr prot.72, datë 22.02.2017 , miratuar me Vëndim të Këshillit të Basenit Ujor Mat me Nr.72, datë 22.02.2017. Lloji i aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret materiali inert: Sistemim rrjedhje lumore, rehabilitim brigjesh dhe shtrati lumor.

Periudha e vlefshmërisë : 22.02.2017-21.02.2022.

Po ashtu, subjekti është i pajisur me Vendim Nr.52, datë 22.02.2017 “Për miratimin e lejes për përdorim uji Teknologjik”, lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujor Mat.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI AKSIONARE”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	K22113003Q			
2. Data e Regjistrimit	13/09/2002			
3. Emri i Subjektit	RAFAELO 2002			
4. Forma ligjore	Shoqëri Aksionare			
5. Data e themelimit	13/09/2002			
6. Kohëzgjatja	Nga: 13/09/2002 Deri:			
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njësia Bashkiake nr.11, Rruga 29 Nentori, kthesa e Kamzës, zonë kadastrale nr.8310, numër pasurie 12/104.			
8. Kapitali	1.852.000.000,000			
9. Vlera e kapitalit të shlyer:	1852000000.0000			
10. Numri i aksioneve:	1.852.000,000			
10.1 Vlera nominale:	1.000,000			
11. Kategoritë e aksioneve të shoqërisë	të zakonshme	me përparësi	me të drejta vote	pa të drejta vote
11.1 Numri për secilën kategori				
12. Objekti i aktivitetit:	Import-Eksport të mallrave industriale, ushqimore, materiale ndërtimi (nga të gjitha llojet). Makineri dhe pjesë ndërtimi, mallra elektrike, hidraulike dhe hidrosanitare, lende drusore, të përpunuara			



Fig. 1 Pjese nga ekstrakti i subjektit

2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

2.1. Qëllimi i projektit

Qëllimi i projektit është franksionimi i inerteve lumore.

Projekti ka për qëllim franksionimin e inerteve lumore të siguruara nga shfrytëzimi në lumin Mat.

2.2. Vendndodhja e aktivitetit

Impianti i franksionimit ndodhet në largësi 2.8-3.2 km larg nga qyteti i Milotit dhe rreth 1.3-1.45 km larg nga superstrada Tiranë –Lezhë.

Sheshi i ndërtimit ku është vendosur impianti i franksionimit është në territorin administrativ të Njësisë Administrative Shënkoll, Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë.

-Sipërfaqja ku janë vendosur të gjitha instalimet e impiantit është 6000 m².

-Kapaciteti i impiantit 40000 m³/vit.

2.3. Procesi teknologjik dhe karakteristikat e tij

Lënda e parë për impiantin e franksionimit të inerteve të shoqërisë “Rafaelo 2002” shpk Shënkoll-Lezhë, është zhavor lumi me përmasa 0- 180 mm, siguruar nga kontrata e furnizimit me inerte lidhur me shoqëritë e licencuara.

Instalimet kryesore të impiantit janë:

-Bunker i jashtëm me kapacitet 30 m³.

Ndodhet jashtë kufijve të përcaktuar të impiantit dhe është ndërtuar në anë të rrugës dhe bregut të lumit Mat me qëllim që ti vinte në ndihmë nyjes së franksionimit duke shmangur përdorimin e automjeteve të transportit . Bunker i ka qënë i lidhur me një transportier që dërgontë materialin inert nga ky bunker tek bunker kryesor i impiantit me kapacitet 15 m³.

-Bunker furnizues me kapacitet 15 m³ ngjitur me murin e thyerjes.







Mulliri
Thyeres

Bunkei
Furnizues
15m³


Foto1. Ne foto tregohet bunkei me kapacitet 15m³ dhe mylliri thyeres HPP 200

3. Mulliri i thyerjes me thyeres konik me kapacitet 120 m³/h(Marka Metso minerals HP 200 kW).
4. Transportiere (Transportieri Bunkei-Shoshe e parë).





Shosha e Parë , është thjesht shoshe ndarëse dhe punon në të thatë pa prezencë uji , e ka dy nivele sitash.



Kati I-re e ka me katror 35x35 mm
Kati II-te e ka me katror 25x25 mm

Shosha Pare

Transportieri
Shoshe Pare
- Bunker
Furnizues



Bunker grumbullues

Inertet e lumit janë me permasa nën 25 mm , kalojnë në proces larje dhe ndarjeje në Shoshën e dytë. Inertet e lumit të cilat janë me permasa mbi 25 mm, me anë të transportit shkojnë në bunkerin 10 m³, i cili me anë të një kompjuteri me transportier i kalon tek mulliri thyeres HP 200.





- Shosha e dytë e Larjes
- Impianti Larjes
- Puset e ujit

Shosha e dytë e larjes , punon me prezencë uji dhe ka tre nivele sitisje:

- Kati I-re- Site me katror 4mm që nxjerr rërën 0-4mm.
- Kati II-të-Site me katror 8 mm që nxjerr Granilin 1 (nga 4-8mm)
- Kati III-te- Site me katror 16 mm që nxjerr Granilin 2 (8-16mm)

Materiali inert që del mbi siten 16 mm (pra përmasat e të cili janë mbi 16 mm) me anë të një transportieri kalojnë në bunkerin 10 m³, i cili më vonë (pasi mbushet) e kalon këtë material me transportier në mullirin thyeres HP 200.



Tubi 400mm i largimit te argjiles dhe ujit lares




Nga i gjithë materiali inert që futet në ciklin e fraksionimit , 10 % janë firo teknike(e llojit argjile) që nga lërësja e rërës , me anë të një tubi 400mm kalon jashtë argjinaturës dhe del e derdhet sërish në lumin Mat.

Impianti punon me ujë i cili është i siguruar nga një pus gjeologjik me thellësi 40 mm. Uji pompohet nga 4 pompa me fuqi 18 kW dhe presipon deri në 4bar.

Gjithashtu, për të siguruar funksionimin e impiantit është hapur dhe një pus tjetër gjeologjik rezerve. Linja ka një impiant komandimi të centralizuar , të komanduar nga kompjutera.

Linja e thyerjes së granilit të larë thyer Granilin 1 dhe Granilin 2 për ti kthyer në rërë betoni 0-7mm.





3. INFORMACION PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS.

Shkarkimet në mjedis gjatë fazës së funksionimit të këtij aktiviteti do të jenë minimale.

3.1. Identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis.

Një nga objektivat e këtij raporti është identifikimi i ndikimeve të mundshme që mund të shkaktohen në mjedis nga ky aktivitet në terësi. Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedisin e kësaj zone do të vlerësohen në një tërësi prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi aktiviteti është ekzistues dhe ndikimi në mjedis do të jetë vetëm gjatë ushtrimit të aktivitetit.

Shkarkime në ujë

Ujërat industriale që përdoren në linjën e funksionimit, kalojnë në vaskat e dekantimit dhe kryhet trajtimi i tyre para shkarkimit në mjedisin ujor pritës.

Emetimet në ajër.

Referuar natyrës së procesit nuk kemi sasi emetimesh gazi të shkarkuar në atmosferë, por vetëm pluhur. Subjekti përdor sistemin e spërkatjes me ujë here pas here, ndërsa makinat transportuese janë të mbuluara. Gazet e gjeneruara prej mjeteve të punës, janë në intervale të shkurtra kohore, brenda normave të lejuara pa asnjë ndikim në mjedisin përreth.

Ndikimet në tokë.



Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë negativisht në tokë, kjo vjen si rezultat se nuk do të ketë gjenerim mbetjesh të rrezikshme.

Ndikimet në florë/ faunë.

Impianti i franksionimit ndodhet në një zonë ku nuk takohen elemente të spikatur të florës. Po ashtu, bazuar në vëzhgimet e terrenit nuk është e vështirë që të nxirret si përfundim që fauna është e varfër.

Mbetjet e prodhuara.

Gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti, mbetjet që do të prodhohen do të menaxhohen duke respektuar legjislacionin në fuqi për menaxhimin e mbetjeve. Grumbullimi i mbetjeve do të jetë i diferencuar që në vendburim për ato mbetje që është e mundur të kryhet ky proces. Në ndihmë do të vijnë edhe konteineret e Njësisë Administrative përkatese.

Operatorit do ti rekomandohet vendosja e konteniereve me ngjyra në mënyrë që të kryhet edhe diferencimi i tyre në vendndodhje, gjithashtu duhet të jenë të mbyllur në mënyrë që të evitohen aromat e pakëndshme në ditët kur kushtet atmosferike janë të papërshtatshme.

Mbetjet teknologjike si mbetje zhavorri, mbetje guresh, sterile , mbetje pluhurash etj , nuk do të trajtohen në vendndodhje , por do të ripërdoren në impiantin e franksionimit.

Nga ky aktivitet, nuk do të gjenerohen mbetje të rrezikshme.

Ndikime nga zhurmat

Zhurmat shkaktohen nga mjetet e ngarkimit-shkarkimit, sitat vibruese dhe mulliri. Këto zhurma janë brenda normave të lejuara dhe vetëm brenda orarit të punë. Megjithatë, shoqëria ka pajisur me punëtorë me mjete mbrojtëse ndaj saj. Impianti është larg qendrave të banuara.

3.2. Masat e nevojshme për zbutjen e ndikimeve

Ndikimet negative në mjedis gjatë shfrytëzimit të objektit janë në nivele të ulta. Disa prej masave kryesore që do të ndërmerren janë përmendur në mënyrë të përmblëdhur si më poshtë shënuar.

- Kontrollin dhe mbajtjen e ndikimeve brenda zonës së aktivitetit;
- Shmangien e efekteve negative në shëndet dhe mjedis;
- Kufizimi i veprimtarisë vetëm brenda impiantit;
- Kontrolli i pluhurave nepërmjet sistemit të spërkatjes;
- Kontrolli i automjeteve për të parandaluar rrjedhjet e karburantit dhe cilimet tej normave të lejuara.



- Vendorsja e kontenierëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre në vendepozitim më të afërt të caktuar nga njësia administrative.
- Pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave teknologjike të larjes dhe të shiut.
- Mbjellja e pemëve dekorative përreth objektit për të krijuar një ambient të pastër dhe rekreativ.

Do të respektohen të gjitha kushtet dhe masat në Lejen e Mjedisit që do të vendosen nga AKM-ja dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

4.PROGRAMI I MONITORIMIT

4.1 Qëllimet e monitorimit mjedisor

Qëllimi i monitorimit mjedisor është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

4.2 Objektivat e Monitorimit:

- Për të zbuluar ndryshimet dhe për të karakterizuar saktësisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit të burimeve. Për të siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) të burimeve dhe shkaqeve të tyre.
 - Për të evidentuar cilësinë e mjedisve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetësor, me synim për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e tyre.
 - Për të vlerësuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve për menaxhimin e burimeve natyrore.
 - Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në zonë, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
 - Të krijojë një arkivë (regjistër) të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.



- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar.

5. PËRPARESITË E PROJEKTIT/PËRFUNDIME

- Gjatë funksionimit të tij nuk do të shkaktohet ndotje te medha te tokës, ajrit, ujit.
- Me vendosjen e kontenjereve të veçantë për grumbullimin e mbeturinave që do të gjenerohen nga zhvillimi i aktivitetit, dhe nënshkrimi i kontratave me subjektet e licensuara për trajtimin e tyre, do të zgjidhet problemi i trajtimit të tyre dhe në të njëjten kohë do të parandalojë ndotjen e mjedisit.



ANEKSI 1

Pamje nga impianti ku zhvillohet aktiviteti.










ANEKSI 2

Hartat e rehabilitimit te shtratit te lumit




SHPLEGUES


- Rehabilitimi i objektit
- Kufiri i lloqes se shtrypjesit
- Bruçe çapure
- Dymis e gule e lumbi
- Kufiri i sipërfaqesive

OBJEKTI I INERTEVE SHENKOLL - LEZHE		PROFILI I REHABILITIMIT	
POROSITI	"RAFAELO" Sh.p.k	Shkalla	NR VITI
PUNORI	ING. GJ. KAZA	V 1 : 150	2011
KONTROLOI	ING. GJ. KAZA	H 1 : 2000	
OPERATORE	ING. V. GJONAJ	FAZA E ZBATIMIT	

PROFILI GJEOLGJIK I - I OBJEKTIT I INERTEVE SHENKOLL - LEZHE (SUBJEKTI "RAFAELO 2002")
SHKALLA V - 1 - 100, H - 1 - 2000



PROFILI GJEOLGJIK II - II OBJEKTIT I INERTEVE SHENKOLL - LEZHE (SUBJEKTI "RAFAELO 2002")
SHKALLA V - 1 - 100, H - 1 - 2000




- SHPREJEGUES
- Vegetacione shprehur sipas sezonit
 - Organizime ujore sipas sezonit
 - Jete ujore sipas sezonit
 - Kopshte dhe qendrat e banimit
 - Kopshte sipas sezonit


OBJEKTI INERTEVE SHENKOLL - LEZHE		Skala:	1:100
INVENTARIZIMI		Shekulli:	2002
PROJEKTI		Shekulli:	2002
PROFILI GJEOLGJIK		Shekulli:	2002
1 - I - II		Shekulli:	2002



PROFILI I - I REHABILITIMIT TE RRJEDHES
 OBJEKTI I INERTEVE SHENKOLL - LEZHE (SUBJEKTI "RAFAELO 2002")
 SHKALLA V - 1 : 100, H - 1 : 2000



PROFILI II - II I REHABILITIMIT TE RRJEDHES
 OBJEKTI I INERTEVE SHENKOLL - LEZHE (SUBJEKTI "RAFAELO 2002")
 SHKALLA V - 1 : 100, H - 1 : 2000




SHPREKUES
 Figura e velt ne shtetes te projektimit te rrjedhes
 [Symbol] Zonat e rrjedhes
 [Symbol] Hapesa e rrjedhes te rrethimit

OBJEKTI I INERTEVE SHENKOLL, LEZNE		Shkalla V	H - 1 : 2000
PROJEKTORESI	"RAFAELO 2002" SH.P.A.	PROJEKTI	"REHABILITIMI I RRJEDHES TE RRJEDHESIT TE RRJEDHES"
PROJEKTORI	ING. GJ. KAZI	PROJEKTORE	ING. GJ. KAZI
RIKONTROLLO	ING. N. NIKOLLI	RIKONTROLLO	ING. N. NIKOLLI



PLANIMETRIA E HEQJES SE ISHUJVE MIDIS RRJEDHES
DHE E NDERTIMIT TE KANALIT TE RRJEDHES
SHKALLA 1 : 2000



PLANIMETRIA E VENDOSJES SE MATERIALIT INERT
SUBJEKTI "RAFAELO"SH.P.K.

SHKALLA 1 : 1000

